

**AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "Fonema" Sh.p.k.**

Sot, me datë 15.08.2025,

- **Z.Altin Zefi**, shtetas shqiptar, lindur më 10/03/1986, në Pukë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. Personal I60310047T, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Fonema" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1
EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "Fonema" Sh.p.k.

**NENI 2
SELIA**

Shoqëria ka seli në adresë: Durrës, Lalëz me Nr pasurie (172/242/ND45+1-6). Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4
OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

Dhënie me qera, nën qera, B & B të ambjenteve të ndryshme, si dhe çdo veprimtari tjetër e cila i shërben përmbushjes së qëllimit të shoqërisë.


-Aktivitet në fushën e pasurive të patundshme, vlerësimin e pasurive të patundshme, të angazhohet në shitjen me shumicë dhe pakicë të çdo lloj pasurie.. Manaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

**NENI 5
KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 1.000.000 Lekë (një milion) dhe është i përbërë nga një kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:



- **Z. Altin Zefi**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.000.000 (një milion) Lekë dhe 1.000.000 (një milion) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Z. Altin Zefi** shtetas shqiptar, lindur më 10/03/1986, në Pukë, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. Personal I60310047T, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 1 (një) vit, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Z. Altin Zefi** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

Altin Zefi